

Projektbuxheti 2019



Analizë e të hyrave dhe
shpenzimeve buxhetore



Nëntor 2018

Hyrje

Buxheti i Kosovës vazhdon të mbetet një nga instrumentet më të rëndësishëm me anë të së cilit do të duhej të adresoheshin problemet thelbësore ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Kosovës. Në këtë analizë të shkurtër, kemi identifikuar disa nga zhvillimet kryesore sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve në projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2019. Struktura e shpenzimeve është analizuar në detaje duke i krahasuar të gjeturat me rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian (KE) 2018 për Kosovën.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve, të gjeturat tregojnë se ky buxhet paraqet në masë të madhe vazhdimësi të buxheteve nga vitet e kaluara. Kjo për arsye se ngjashëm me vitet e kaluara, gati gjysma e investimeve kapitale do të menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës (MI) dhe shumica prej tyre do investohen në infrastrukturë rrugore. Gjithashtu, 82% e investimeve kapitale të nivelit qendror janë vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara.

Zhvillim pozitiv në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm dhe që përputhet edhe me rekomandimet e KE-së është rritja e buxhetit për shëndetësi dhe disa institucione që merren me funksionimin e tregut. Gjithashtu, edhe rritja e buxhetit për Agjencinë për Punësim dhe numri i punëtorëve në Inspektoratin e Punës janë në përputhje me sugjerimet e KE-së për Kosovën. Edhe shpenzimet në arsim janë rritur dukshëm mirëpo ato ende mbesin nën nivelin e shpenzimeve relative të shteteve të BE-së. Gjithashtu, për herë të parë është ndarë granti shtesë për kryeqytetin i cili do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve buxhetore të Komunës së Prishtinës për adresim të problemeve të të gjithë banorëve që jetojnë apo kryejnë shërbime në kryeqytet.


Në anën tjetër, në mungesë të një ligji të ri për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), ky institucion ka mbetur nën financimin e buxhetit të Kosovës. Përveç subvencionimit të RTK-së, edhe kategoritë tjera të subvencioneve siç janë pensionet dhe kompenzimet janë rritur dukshëm, ndërsa me gjithë kontestimet për numrin e veteranëve të luftës, buxheti për këtë kategori është rritur tutje. Sa i përket shpjegimeve të dhëna dhe orientimit të shpenzimeve, ky buxhet nuk e merr fare parasysh perspektivën gjinore të buxhetit. Përveç diskriminimit gjinor, të dhënat e ndarjes së investimeve kapitale nga MI sugjerojnë se ka edhe diskriminim të komunave të qeverisura nga disa parti të cilat nuk janë të përfshira në Qeverinë e Kosovës.

Të gjeturat kryesore

Është rritur financimi nga kreditë dhe të hyrat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) krahasuar me të hyrat e rregullta buxhetore.

Shpenzimet për vitin 2019 pritet të jenë rreth 2.4 miliardë euro, që shënon një rritje të shpenzimeve rreth 261 milionë euro apo 12% krahasuar me vitin e kaluar. Për dallim nga viti 2017, kur 95% e buxhetit ishte financuar nga të hyrat buxhetore, në projektbuxhetin e vitit 2019 këto të hyra përbëjnë 82% të shpenzimeve. Pesa e financimeve nga kreditë dhe të hyrat e njehershme të AKP-së është rritur nga 5% në vitin 2017 në 18% në vitin 2019. Në terma absolut, nevoja për financim është rritur nga 82 milionë euro (2017) në 416 milionë euro që shënon një rritje prej 334 milionë euro apo 407%. Të hyrat e buxhetit janë rritur për 132 milionë euro (7%) krahasuar me vitin e kaluar dhe kjo paraqet një trend të njëjtë me periudhën paraprake (2018/2017).



Figura 1 . Struktura e financimit të buxhetit



Shpenzimet rrjedhëse janë rritur më shpejt se ato kapitale.

Krahasuar me shpenzimet rrjedhëse (ku përfshihen pagat dhe meditet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet dhe rezerva rrjedhëse), shpenzimet kapitale janë më të prirura të nxisin zhvillim ekonomik. Krahasuar me periudhën paraprake (2017 dhe 2018) rritja e shpenzimeve është ngadalësuar për 7 pikë përqindje (p.p). Mirëpo, shpenzimet rrjedhëse janë rritur më shpejt se ato kapitale - 181 milionë euro (13%) krahasuar me vetëm 76 milionë euro (11%) rritje të shpenzimeve kapitale.


Figura 2. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale



Pesha e investimeve kapitale në shpenzime është mbajtur vetëm fal të hyrave të njehershme të AKP-së dhe kredive.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve në bazë të peshës, në projektbuxhetin 2019 proporcioni në mes shpenzimeve rrjedhëse dhe atyre kapitale do mbetet i njëjtë më vitin 2018, 66% dhe 33% respektivisht. Mirëpo, struktura e aktuale e shpenzimeve është mbajtur vetëm fal kredive nga jashtë dhe të hyrave nga likuidimet e AKP-së. Sipas planifikimeve, në vitin 2019 vetëm 66% e investimeve kapitale do të investohen nga të hyrat e rregullta, krahasuar me 79% të financimit në vitin 2018. Në vitin 2020, të hyrat nga kreditë e kaluzolës së investimeve do të rriten tutje.


Figura 3. Financimi i shpenzimeve kapitale



Janë rritur kategoritë e subvencioneve dhe transfereve dhe mallrave dhe shërbimeve.

Kontributin më të madh në rritjen e shpenzimeve rrjedhëse në projektbuxhetin 2019 do ta bëjnë rritja e subvencioneve dhe transfereve dhe mallrave dhe shërbimeve të cilat janë rritur për 83 milionë euro (16%) dhe 72 milionë euro (27%), respektivisht. Rritja e kategorisë së subvencioneve do të shkojë më së shumti në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Ministrinë e Financave (MF), ndërsa mallrat dhe shërbimet më së shumti janë rritur në MF, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Zyrën e Kryeministrit dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK).

Figura 4. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse




Gati gjysma e investimeve kapitale do të shpenzohen në infrastrukturë rrugore.

Ngjashëm me vitet e kaluara, gati gjysma e investimeve kapitale (288 milionë apo 48%) do të menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës (MI). Nga kjo shumë e investimeve kapitale të MI-së, 266.4 milionë apo 92% e investimeve të MI-së do të investohen në infrastrukturë rrugore. Ministri tjetër me një rritje të theksuar prej 34% të investimeve kapitale është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) e cila do të menaxhojë rreth 65.9 milionë euro (11%) të investimeve të përgjithshme kapitale.

Rreth 82% e buxhetit për investime kapitale qendrore do të investohet në projekte që janë vazhdimësi e viteve të kaluara.

Nga gjithsej 604 milionë euro investime kapitale të nivelit qendror, 82% apo 496.8 milionë euro do të investohen në projekte të cilat kanë filluar në vitet e kaluara, ndërsa pjesa e mbetur do të investohet në projekte të reja për vitin 2019.

Figura 5. Investimet e reja kapitale krahas atyre të vazhduara



Investimet kapitale nga niveli qendror vazhdojnë të orientohen në baza partiake.

Prej rreth 62.4 milionë euro që parashikohen të investohen në komuna nga MI, shumica më e madhe apo rreth 32% do të investohen në komunat e menaxhuara prej subjektit politik AAK (shtatë komuna). Në ato komuna jetojnë rreth 18% e popullsisë dhe zënë rreth 19% të sipërfaqes së Kosovës. Komunat e menaxhuara nga LDK (tetë komuna) përfshijnë 28% të popullsisë dhe zënë rreth 29% të sipërfaqës. Në këto komuna do të investohet rreth 19% nga totali i investimeve të MI-së. Më tutje, komunat të cilat menaxhohen nga PDK (5 komuna) zënë rreth 13% të sipërfaqes dhe përfshijnë 14% të popullsisë. Në këto komuna do të investohen rreth 13% e totalit të investimeve. Kurse në komunën e menaxhuara nga VV (një komunë) do të investohet rreth 3% e buxhetit. Në këtë komunë jetojnë 11% e popullsisë dhe zënë 6% të sipërfaqes së Kosovës. Në komunat e menaxhuara nga PSD

(dy komuna) jetojnë 13% e popullsisë, zënë 9% të sipërfaqes dhe në këto komuna janë investuar 22% e investimeve kapitale të MI-së.

Siç shihet në figurën 6, gjatë ndarjes së buxhetit nga MI, janë vërejtur dallime në përqindje të popullsisë dhe përqindje të investimeve nëpër komuna. Sa i përket përqindjes së investimeve krahas popullsisë, komunat e qeverisura nga LDK janë diskriminuar negativisht kurse komunat të cilat menaxhohen nga AAK janë favorizuar. Nëse shikojmë grafikonin vërejmë se komunat e qeverisura nga subjektet politike PDK, AKR dhe NISMA kanë dallime më të vogla në mes të dy variablave të lartpërmendura.

Komuna e Gjakovës që menaxhohet nga AAK përfshin 5.3% të popullsisë kurse në të do investohen 20.3% nga totali i buxhetit për komuna. Pas Gjakovës, komuna e dytë e cila është favorizuar është komuna e Prishtinës. Menaxhuar nga VV, Prizreni është komuna me diskriminim më negativ. Kurse pas Prizrenit komuna e dytë me diskriminim negativ është komuna e Drenasit e cila menaxhohet nga PDK.

Figura 6. Investimet në komuna nga Ministria e Infrastrukturës




Figura 7. Investimet në komuna nga MI

Komuna	Përqindja e investimeve	Përqindja e popullsisë	Përqindja sipërfaqja	Partia e kryetarit	Investimet për kokë banori (euro)
Gjakovë	20.3%	5.3%	5.4%	AAK	132.8
Prishtinë	19.3%	11.8%	4.7%	PSD	57.0
Ferizaj	8.5%	5.7%	3.2%	PDK	51.3
Podujevë	5.8%	4.6%	5.8%	LDK	43.6
Skenderaj	5.3%	2.9%	3.4%	I pavarur	63.1
Deçan	3.6%	2.3%	2.7%	AAK	53.1
Pejë	3.5%	5.5%	5.5%	LDK	22.0
Vushtrri	3.4%	3.6%	3.2%	LDK	33.3
Klinë	3.3%	2.2%	2.8%	AAK	51.8
Dragash	3.1%	1.9%	3.9%	PDK	56.8
Gjilan	2.7%	4.5%	3.6%	LDK	21.2
Prizren	2.7%	10.7%	5.5%	VV	8.8
Mitrovicë	2.5%	3.9%	3.0%	AKR	22.9
Kamenicë	2.3%	1.7%	3.9%	PSD	46.5
Malishevë	2.1%	3.2%	2.8%	NISMA	22.2
Junik	1.7%	0.4%	0.7%	AAK	169.4
Obiliq	1.5%	1.1%	1.0%	AAK	48.1
Viti	1.4%	2.6%	2.5%	LDK	18.2
Lipjan	1.3%	3.2%	3.1%	LDK	13.7
Istog	1.0%	2.2%	4.2%	LDK	15.5
Rahovec	0.9%	3.3%	2.6%	AAK	9.4
Shtërpcë	0.7%	0.4%	2.3%	LS	60.3
Shtime	0.6%	1.5%	1.2%	PDK	14.1
Drenas	0.6%	3.4%	2.5%	PDK	6.1
Suharekë	0.6%	3.3%	3.3%	AAK	6.1
Kaçanik	0.4%	1.9%	1.9%	PDK	8.0
Hani i Elezit	0.4%	0.6%	0.8%	I pavarur	23.6
Fushë Kosovë	0.3%	2.1%	0.8%	LDK	4.8
Graçanicë	0.2%	0.7%	1.2%	LS	8.3
Klllokot	0.0%	0.2%	0.2%	Iniciativa Qytetare	0.0
Leposaviq	0.0%	0.8%	4.9%	LS	0.0
Mamushe	0.0%	0.3%	0.3%	KDTP	0.0
Mitrovicë veriore	0.0%	0.7%	0.0%	LS	0.0
Novobërdë	0.0%	0.4%	1.9%	LS	0.0
Partesh	0.0%	0.1%	0.3%	LS	0.0
Ranillug	0.0%	0.2%	0.6%	LS	0.0
Zubin Potok	0.0%	0.4%	3.1%	LS	0.0
Zvečan	0.0%	0.4%	1.1%	LS	0.0

Është rritur dukshëm buxheti për shëndetësi.

Në total, projektbuxheti për MSH, SHSKUK dhe Granti për shëndetësi për komuna do të jetë rreth 225.6 milionë euro apo një rritje prej 31.0 milionë euro (16%) krahasuar me vitin 2018. Sa i përket buxhetit të MSH-së dhe SHSKUK-së, kategoritë ekonomike të cilat do të rriten më së shumti janë ato të shpenzimeve kapitale (rritje prej 11.7 milionë euro apo 47%) dhe mallrave dhe shërbimeve (rritje prej 11.5 milionë euro apo 25%). Rritja e shpenzimeve në shëndetësi është në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian (KE) për Kosovën ngase shpenzimet publike në shëndetësi janë të pamajftueshme. Krahas rritjes së cilësisë, duhet që të rritet llogaridhënia institucionale dhe hartimi i një strategjie për të rritur produktivitetin, efikasitetin dhe cilësinë në këtë sektor.¹

Sipas një vlerësimi në vitin 2016, nevojat e përgjithshme vjetore për shëndetësi u përmbushën vetëm 40%. Shpenzimet që bëjnë për shëndetësi, qytetarët e vendeve si Kosova (40%), Shqipëria (49.9%) apo Mali i Zi (42.8%) nga xhepi i tyre, si përqindje e shpenzimeve totale për shëndetësi në vend, llogariten të jenë rreth dyfish i asaj që shpenzojnë qytetarët e Bashkimit Evropian.² Me gjithë rritjen e buxhetit për shëndetësi, krahasuar me vendet e BE-së, Kosova shpenzon rreth 3.8 pikë përqindje më pak në shëndetësi krahasuar me Bruto Produktin Vendor (BPV).

Figura 8. Buxheti për shëndetësi





Figura 9. Shpenzimet në shëndetësi (% e BPV-së)



Burimi: Eurostat dhe kalkulum i Institutit GAP me të dhënat e projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2019


¹ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <https://bit.ly/2lhNbfz>

² Ekonomisti, Njësia e Intelejgencës. Modernizimi i sistemeve shëndetësore në Ballkan. Burimi: <https://bit.ly/2jyJkD>

Është rritur buxheti për pensione dhe kompenzime.

Buxheti i MPMS-së planifikohet të jetë 465.8 milionë euro. Krahasuar me vitin 2018, buxheti i kësaj ministrie planifikohet të rritet për 57 milionë euro (14%). Kategoria me rritjen më të madhe është ajo e subvencioneve dhe transfereve e cila është rritur në 456 milionë euro nga 398.4 milionë euro që përbën një rritje prej 58 milionë euro apo 15%. Kjo për shkak të rritjes së pensioneve dhe kompenzimeve.

Figura 10. Buxheti i MPMS-ës



Në figurën 10 është paraqitur buxheti i MPMS-së në nivel të programeve për vitin 2018 dhe 2019. Buxheti për pensione dhe kompenzime planifikohet të rritet për rreth 52 milionë euro (20%) në krahasim me vitin 2018. Në këtë rritje më së shumti do kontribuojnë rritja e pensioneve bazike sociale (24.2 milionë euro apo 21%); pensionet e kontributdhënësve (21 milionë euro apo 24%) dhe pensionet për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët (rreth 11 milionë euro apo 76%).

Sa i përket veteranëve të luftës, buxheti i ndarë për vitin 2019 është 60.6 milionë euro apo një rritje prej 1.8 milionë euro krahasuar me vitin e kaluar. Gjatë këtij viti, 97% e buxhetit për veteran është shpenzuar deri në muajin shtator dhe Qeveria e Kosovës është detyruar të ndajë fonde shtesë prej rreth 11.2 milionë euro gjatë muajit tetor dhe nëntor.³ Duke marrë parasysh këtë, në rast se nuk ulet numri i veteranëve gjatë vitit 2019, atëherë buxheti i ndarë do jetë i pamjaftueshëm.

³ Qeveria e Republikës së Kosovës, Raporti nëntëmujor financia – Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën 1 janar- 30 shtator 2018, Burimi: <http://bit.ly/2QYHwzF>

Është rritur buxheti për Agjencinë e Punësimit dhe numri i lejuar i inspektorëve të punës. Buxheti i Agjencisë së Punësimit është rritur për 4.2 milionë euro apo 80% rritje krahasuar me vitin 2018. Shumica e rritjes së buxhetit është ndarë për subvencione dhe transfere. Gjithashtu, edhe buxheti për paga dhe mëditje është rritur tek Inpektorati i Punës për rreth 50 mijë euro apo 10%, ndërsa numri i lejuar i të punësuarve për 10 persona. Rritjen për buxhetin e Agjencisë së Punësimit e ka rekomanduar edhe KE duke e konsideruar buxhetin e kësaj agjencie të ulët.⁴ Krahas kësaj, KE ka konstatuar së numri aktual i inspektorëve të punës është i ulët.⁵ Ndër të tjera, KE ka rekomanduar edhe rritjen e buxhetit për trajnime profesionale, mirëpo buxheti për nënprogramin e Shërbimit të Aftësimin Profesional është rritur për vetëm 4%, ndërsa për Agjencinë e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në MASHT është rritur për 6%.

Projektbuxheti nuk e merr parasysh perspektivën gjinore. Ligji për barazi gjinore kërkon që perspektiva gjinore të futet në çdo fazë të procesit të planifikimit, miratimit, zbatimit dhe vlerësimit të legjislatonit. Mirëpo, vlerësimi gjinor i buxhetit nuk është bërë në asnjërin nga dokumentet e buxhetit qoftë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve apo Projektligjin për ndarjet buxhetore. Për më tepër, siç u përmend më lartë gati gjysma e investimeve kapitale do të invesohet në infrastrukturë rrugore, ndërsa 98% e të punësuarve në sektorin e ndërtimit janë burra.⁶ Gratë diskrimohen edhe në kategorite tjera ekonomike të ndarjes së buxhetit siç janë ajo e pagave dhe medijtjeve dhe subvencioneve. Shumica e të punësuarve në pozitat udhëheqese janë burra, ndërsa burrat janë gjithashtu përfituesit më të mëdhenjë nga transferet sociale.⁷

4 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <https://bit.ly/2lhNbzf>, faqe 42

5 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018, Burimi: <https://bit.ly/2lhNbzf>, faqe 59


6 ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 2018, Burimi: <http://bit.ly/2znLmuX>

7 Institutit GAP, Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë, Burimi: <http://bit.ly/2qWSABx>

Në përputhje me rekomandimet e KE-së është rritur buxheti për disa institucione që sigurojnë funksionimin e tregut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Raporti ka konsideruar se një sërë institucionesh në MTI kanë mungesë të burimeve njerëzore. Për disa nga këto institucione siç janë: Drejtoria e Akreditimit të Kosovës, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, dhe Agjencia për Pronësi Industriale, është rritur numri i punonjësve për një person, ndërsa tek Agjencia për Metrologji, numri i stafit është rritur për katër persona. Gjithashtu, buxheti i Agjencisë për Metrologji parasheh rritje buxhetore prej 1.4 milionë euro, kryesisht kjo ngritje vjen nga klauzola e investimeve. Edhe për Inspektoratin e Tregut parashihet rritje thelbësore e buxhetit prej 662 mijë euro (235%) që pjesa më e madhe shkon për investime kapitale. Institucioneve të cilave nuk i'u është rritur numri i lejuar i punëtorëve mirëpo ka një nevojë për këtë janë: Agjencia Kosovare për Standardizim dhe Inspektorati i Tregut.


Figura 11. Buxheti i MTI-së



Shpenzimet në arsim mbesin më të ulëta se mesatarja e shpenzimeve relative në BE.

Shpenzimet në arsim në vitin 2019 do të jenë rreth 292.4 milionë euro që shënon një rritje prej 10% për këtë sektor. Edhe në vitin 2019 prioritet në buxhet nga MASHT pritet të ketë ndërtimi i objekteve shkollore ku do të ndërtohen 38 të tilla dhe një numër i konsiderueshëm i sallave sportive. Mirëpo, probleme në arsim, siç thekson edhe Raporti i KE-së në vitin 2018, mbeten cilësia përgjithësisht e dobët dhe mos përshtatja e programeve të arsimit me nevojat e tregut, mos fuqizimi i mekanizmave monitorues të cilësisë dhe mungesa e programeve në shkollat profesionale me fokus në anën praktike dhe lëndët e aplikuara.⁸ Programet që trajtojnë këto çështje, sikurse ajo për trajnimin e mësimeve kanë një rritje buxhetore prej 50 mijë euro apo 13%. Edhe buxheti për programin për zhvillimin e planprogrameve në arsim parauniversitar ka shënuar një rritje prej 57 mijë euro apo 40%. Hap i mirë këtë vit është përkrahja buxhetore për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme me 200 mijë euro.

Figura 12. Përqindja e shpenzimeve për BPV në arsim në shtetet e BE-së



Burimi: Eurostat dhe kalkulum i Institutit GAP me të dhënat projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2019

Megjithë rritjen e buxhetit për arsim, krahasuar me vendet e BE-së, Kosova ende shpenzon më pak në arsim. Në mesatare, vendet e BE-së në vitin 2016 shpenzonin 4.7% të BPV-së në arsim, ndërsa me projektbuxhetin e vitit 2019 shpenzimet në arsim në Kosovë do të jenë rreth 4.1% të BPV-së. Kur krahasojmë nivelin e ulët të BPV-së në Kosovë dhe moshën e re të popullsisë, atëherë Kosova do të duhej t'i rriste dukshëm shpenzimet në arsim.

⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2018. Burimi: <https://bit.ly/2lhNbfz>.


Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka mbetur nën financim të buxhetit.

Megjithëse afati ligjor për gjetjen e financimit të qëndrueshëm të RTK-së ka kaluar në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka miratuar një ligj të ri për transmetuesin publik, me anë të së cilit do të adresonte problemin e financimit të RTK-së. Edhe këtë vit RTK do të subvencionohet me 11.2 milionë euro.

Buxheti në sistemin e drejtësisë është rritur konsiderueshëm.

Në total projektbuxheti 2019 parasheh përafërsisht 68.8 milionë euro për Ministrinë e Drejtësisë (MD), Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Akademinë e Drejtësisë (AD), Prokurorin e Shtetit (PSH), dhe Agjencinë Kundër Korrupsion (AKK). Në MD, AD dhe AKK, kjo rritje kryesisht vjen për shkak të rritjes së kategorisë së investimeve kapitale për 580 mijë euro; 550 mijë euro dhe 30 mijë euro respektivisht. Në KGJK, rritja kryesisht vjen për shkak të rritjes së kategorisë së pagave dhe mëditjeve për afro 4.6 milionë euro, ndërkaq në ANJF për shkak të rritjes në mallra dhe shërbime me 40 mijë euro. Megjithë rritjen e buxhetit për paga dhe meditje në KGJK, nuk është rritur numi i lejuar i stafit, ndërsa KGJK ka pasur vazhdimisht kërkesa për rritje të numrit të asistentëve në sistemin gjyqësor.

Figura 13. Buxheti për disa institucione të sundimit të ligjit



Për herë të parë është ndarë granti shtesë për Kryeqytetin e Kosovës.

Pas miratimit të ligjit për Kryeqytetin e Kosovës, krahas ndarjes së grantit qeveritar për komuna, Komunës së Prishtinës i janë ndarë 10.8 milionë euro shtesë për buxhet.⁹ Kjo do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve buxhetore të Komunës së Prishtinës për dhënien e shërbimeve dhe adresimin e problemeve të të gjithë banorëve që jetojnë apo kryejnë shërbime në kryeqytet. Në përputhje me Ligjin për Kryeqytet, granti për Prishtinë është i barabartë me 6% të grantit të përgjithëm për komuna.

9 Ligji nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Burimi: <http://bit.ly/zzkeOSM>


Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:



*Empowered lives.
Resilient nations.*





INSTITUTI GAP

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

